



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 35

2003

Maj

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.238, datë 10.04.2003	Për licensimin e veprimtarisë private në fushën e shëndetësisë	1221
Vendim i KM nr.242, datë 24.4.2004	Për procedurat e privatizimit me tender të hapur të paketave të aksioneve të shoqërisë anonime “Servcom” Fier, si dhe kriteret bazë të përzgjedhjes së investitorëve e të vlerësimit të ofertave	1222
Vendim i KM nr.243, datë 24.4.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.372 datë 27.5.2001 të Këshillit të Ministrave “Për fillimin e procesit të privatizimit e të ristrukturimit dhe për përcaktimin e formës e të struktures së formulës të shoqërisë anonime “Servcom” Fier	1223
Vendim i KM nr.249, datë 24.4.2003	Për miratimin e dokumentacionit për leje mjedisore dhe të elementeve të lejes mjedisore	1224
Vendim i KM nr.258, datë 24.4.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 “Për dispozitat zbatuse të Kodit Doganor”, i ndryshuar	1226

Vendim i KM nr.262, datë 24.4.2003	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2003, miratuar për Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, për financimin e shpenzimeve për hapjen kutive të votimit të përdorura në zgjedhjet për deputet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 24 qershor 2001	1226
Vendim i KM nr.266, datë 24.4.2003	Për administratat e zonave të mbrojtura	1227
Vendim i KM nr.267, datë 24.4.2003	Për procedurat e propozimit dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe buferike	1228
Vendim i KM nr.268, datë 24.4.2003	Për certifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor	1229
Vendim i KM nr.278, datë 8.5.2003	Për miratimin e rregullores së funksionimit të Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM) dhe të Këshillit Teknik të Përhershëm të Digave (KTPD)	1231

V E N D I M
Nr.238, datë 10.4.2003

PËR LICENCIMIN E VEPRIMTARISË PRIVATE NË FUSHËN E SHËNDETËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, shkronja “a” të ligjit nr.3766, datë 17.12.1963 “Për kujdesin shëndetësor” dhe të nenit 43 të ligjit nr.7815, datë 20.4.1994 “Për barnat”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Personat juridikë, vendas ose të huaj, që do të ushtrojnë veprimtarinë në fushën e shëndetësisë, duhen të pajisen me licencë nga komisioni i posaçëm për dhënien e licencave, në Ministrinë e Shëndetësisë.

Veprimtaritë që licencohen nga ky komision janë:

- a. Tregtimi me shumicë e pakicë, eksport-import i barnave.
- b. Tregtimi me shumicë e pakicë, eksport-import i materialeve me përdorim mjekësor.
- c. Hapja e kabineteve dhe e klinikave dentare.
- ç. Hapja e qendrave diagnostikuese, kabineteve mjekësore, klinikave mjekësore dhe laboratorëve mjekësorë.
- d. Hapja e klinikave optike dhe e laboratorëve optikë.
- dh. Ushtrimi i veprimtarisë së lirë mjekësore, sipas përcaktimeve të bëra nga Ministri i Shëndetësisë (mjek, farmacist, stomatolog, personel i mesëm mjekësor).

2. Komisioni pajis me licencë personat fizikë a juridikë, që plotësojnë këto kritere të përgjithshme:

- a. Të jetë i regjistruar në gjykatë si person fizik a juridik, ku të përcaktohet objekti përkatës i ushtrimit të veprimtarisë në fushën e shëndetësisë.
- b. Të ketë leje higjieno-sanitare për mjedisin, ku do të ushtrohet veprimtaria, e shoqëruar me genplanin përkatës.

c. Të jetë anëtar i Urdhrit të Mjekëve (për mjekët dhe stomatologët).

Kriteret e veçanta, sipas llojit të licencës, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

3. Kërkesa për licencim duhet paraqitur me shkrim, pranë sektorit të licencimit të veprimtarisë private, në Ministrinë e Shëndetësisë, së bashku me dokumentacionin e mëposhtëm:

a. Kërkesën me shkrim, së bashku me një vlerësim të shkurtër për veprimtarinë e kaluar dhe atë që do të ushtrojë subjekti fizik ose juridik.

b. Vendimin e gjykatës për regjistrimin si person fizik a juridik.

c. Vërtetimin për anëtarësinë në Urdhrin e Mjekëve (për mjekët dhe stomatologët).

ç. Licencën profesionale të drejtuesit teknik të shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë, (për subjektet juridike si klinika mjekësore, klinika dentare, depo farmaceutike) etj.

d. Deklaratën, ku të thuhet se subjekti fizik ose juridik njeh legjislacionin në fuqi, në fushën e shëndetësisë.

4. Llojet e licencave, që jepen nga komisioni i posaçëm, janë:

- a. Licencë profesionale, individuale.
- b. Licencë e shoqërisë, e cila jepet në bazë të licencës përkatëse profesionale të drejtuesit teknik.

5. Përbërja e komisionit të posaçëm i dhënies së licencave, ku bën pjesë edhe një përfaqësues i Ministrisë së Mjedisit, si dhe mënyra e funksionimit të tij përcaktohen me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

6. Vendimi nr.500, datë 23.11.1992 i Këshillit të Ministrave “Për dhënien e licencave për ushtrimin e profesionit në fushën e shëndetësisë, në profesion të lirë privat”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.242, datë 24.4.2003

**PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT ME TENDER TË HAPUR TË PAKETAVE TË
AKSIONEVE TË SHOQËRISË ANONIME “SERVCOM” FIER, SI DHE KRITERET BAZË
TË PËRZGJEDHJES SË INVESTITORËVE E TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” të ndryshuar dhe të nenit 2 të ligjit nr.8707, datë 1.12.2000 “Për privatizimin e shoqërisë anonime “Servcom””, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përzgjedhja e investorëve strategjikë, që do të marrin pjesë në tenderin e hapur për shitjen e paketës së aksioneve të shoqërisë anonime “Servcom” Fier, në përputhje me vendimin nr.372, datë 27.5.2001 të Këshillit të Ministrave “Për fillimin e procesit të privatizimit e të ristrukturimit dhe për përcaktimin e formës e të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Servcom” Fier”, të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Procedurat e tenderit të bëhen në përputhje me vendimin nr.529, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve, që zotërohen nga shteti, të shoqërive tregtare” me ndryshimet përkatëse.

3. Vlerësimi i ofertave të investorëve strategjikë të bëhet sipas kriterëve të mëposhtme:

- a. Çmimi i ofruar 85 pikë;
- b. Vlera e investimit 5 pikë;
- c. Plani i biznesit dhe cilësia e tij 5 pikë;
- ç. Cilësia e investorit 5 pikë,

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË INVESTITORËVE STRATEGJIKË TË INTERESUAR PËR
BLERJEN E PAKETËS SË AKSIONEVE TË SHOQËRISË “SERVCOM”-SHA, FIER.**

Shtojca 1

I. Midis investorëve, që do të kenë dërguar shprehjen e interesit, duke përmbushur kërkesat e treguara në njoftimin publik në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.529, datë 21.8.1998 “Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve që zotërohen nga shteti, të shoqërive tregtare”, si dhe me ndryshimet përkatëse, ftesa për tender do t’u dërgohet vetëm kandidatëve që përmbushin kërkesat e parashikuara në pikën II, sipas afateve të parashikuara në të.

II. Investorët strategjikë të interesuar, që do të flohen të paraqesin ofertat e tyre të detyrueshme, duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme paraprake:

a. Të jenë persona juridikë.

b. Të kenë një kapital tërësisht të paguar, jo më pak se 5 milionë dollarë ose ekuivalentin e shumës në valutën në të cilën është shprehur kapitali; vlera neto dhe, sipas rastit, vlera neto e konsoliduar duhet të jetë të paktën 10 milionë dollarë.

c. Të jenë shoqëri të specializuara në shërbimet dhe përpunimin e vendburimeve të naftës, të cilat i kanë siguruar këto shërbime gjatë jo më pak se tre vitet e fundit.

Të gjitha këto kërkesa do të vërtetohen nëpërmjet certifikatave zyrtare, të lëshuara nga autoritetet përkatëse ose me anë të dokumenteve të tjera të shkruara, zyrtare.

Palët, të cilat janë në likuidim ose nuk kanë aftësi paguese, janë nën administrim ose

procedime të tjera të ngjashme, ose ndonjë procedim që nënkupton një mosaftësi paguese ose ndërprerje të biznesit, nuk do të pranohen.

V E N D I M
Nr.243. datë 24.4.2003

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.372, DATË 27.5.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR FILLIMIN E PROCESIT TË PRIVATIZIMIT E TË RISTRUKTURIMIT DHE PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS E TË STRUKTURËS SË FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË SHOQËRISË ANONIME “SERVCOM” FIER”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 7, 8, 9 dhe 12 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar dhe të nenit 2 të ligjit nr.8707, datë 1.12.2000 “Për privatizimin e shoqërisë anonime “Servcom””, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.372, datë 27.5.2001 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 4, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:
“ç” Në ndryshim nga procedurat e përcaktuara në kapitullin I, shkronja B dhe C të vendimit nr.119, datë 18.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, transferimi i paketave të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë për punonjësit dhe ish-pronarët e truallit të fillojë pas realizimit të shitjes me tender të paketës së aksioneve.”.
 2. Në pikën 5 fjalët “... Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit” zëvendësohen me “... Ministrit të Ekonomisë.”.
 3. Në pikën 11 fjalët “Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit” zëvendësohet me “Ministria e Ekonomisë” dhe pas tyre shtohen edhe fjalët “Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës.”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.249, datë 24.4.2003

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT PËR LEJE MJEDISORE DHE TË ELEMENTEVE TË LEJES MJEDISORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 37 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, për t’u pajisur me leje mjedisore, paraqesin kërkesën për miratimin e projektit ose të veprimtarisë që do të ushtrojnë dhe dokumentacionin shoqërues, të përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Kërkesa paraqitet në agjencinë rajonale të mjedisit të qarkut, ku do të ushtrohet veprimtaria.
3. Leja mjedisore përmban elementet, kërkesat dhe kushtet që jepen në aneksin 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Ngarkohet Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Aneksi 1

Dokumentacioni i domosdoshëm për të kërkuar leje mjedisore

1. Kërkesa e personit fizik ose juridik drejtuar Ministrisë së Mjedisit për miratimin e projektit dhe për t'u pajisur me leje mjedisore.
2. Përshkrimi i projektit ose veprimtarisë që trajton:
 - a) Karakteristikat e projektit:
 - i) përshkrimi i proceseve kryesore, teknologjia, kapaciteti, lëndët e para, lëndët ndihmëse, produktet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare;
 - ii) program pune për ndërtimin dhe shfrytëzimin;
 - iii) aktivitete të tjera që mund të kërkojnë si pasojë e projektit (p.sh. rrugë të reja, sigurimi i ujit të pijshëm etj.).
 - Vendndodhjen e projektit:
 - i) planimetria me kufijtë e projektit;
 - ii) harta dhe fotografi që tregojnë vendndodhjen e projektit;
 - iii) planet ekzistuese të përdorimit të territorit ku zhvillohet projekti.
 - Ndikimet e mundshme në shëndet dhe mjedis:
 - i) ndikimet në shëndetin e njerëzve, në florë dhe faunë, në tokë, ujë dhe ajër, në klimë dhe peizazh, në trashëgiminë kulturore dhe historike;
 - ii) natyra e ndikimeve (direkte, indirekte, të përhershme, të përkohshme, pozitive, negative);
 - iii) masat për zbutjen e ndikimeve në mjedis;
 - iv) ndikimet me natyrë ndërkufitare.
3. Vendimi i gjykatës për regjistrimin e kërkuarit si person fizik ose juridik.
4. Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis i hartuar nga persona fizikë e juridikë të certifikuar e të zgjedhur nga kërkuari i lejes mjedisore.

Aneksi 2

Elementet që përmban leja mjedisore

1. Emri i Ministrisë së Mjedisit si autoritet që lëshon lejen mjedisore për veprimtaritë që ndikojnë në mjedis.
2. Emri, adresa e personit fizik ose juridik që i jepet leja mjedisore.
3. Referenca ligjore që mbështet dhënien e lejes mjedisore.
4. Detajimi i kushteve për respektimin e normave të shkarkimeve në çdo nyje shkarkuese të veprimtarisë dhe në total, duke i cituar normat e shkarkimeve.
5. Kërkesat për zbatimin e programit të monitorimit duke përfshirë treguesit e gjendjes, të ndikimit, stacionet e marrjes së mostrave dhe frekuencën e matjes së tyre, metodën e matjes ose të llogaritjes, formatet e paraqitjes dhe të regjistrimit të të dhënave.
6. Përcaktimi i masave për uljen e konsumit të lëndëve të para, të ujit e të energjisë dhe për përmirësimin e teknologjisë sipas një programi.
7. Detyrimi për të dorëzuar një herë në tre muaj të dhënat e monitorimit në agjencitë rajonale të mjedisit të qarkut dhe për t'i publikuar ato një herë në vit.
8. Përcaktimi i masave dhe afatet për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar ose të ndotur.
9. Masat për trajtimin e mbetjeve dhe mbetjeve të rrezikshme që krijon veprimtaria.
Masat e detyrueshme restauruese në rast mbylljeje të veprimtarisë.
11. Afatet për përtëritjen e lejes mjedisore, si dhe të skadimit të saj, kur veprimtaria nuk fillon

të ushtrohet.

12. Detyrimi për kryerjen e vlerësimit mjedisor.

13. Detyrimi për zbatimin e kërkesave të lejes edhe kur veprimtaria kalon në pronësi ose përdorim të një personi tjetër.

14. Sanksionet në rast mosrespektimi të kushteve të lejes mjedisore.

Tarifa e lejes mjedisore.

Data e hyrjes në fuqi e lejes.

V E N D I M
Nr.258, datë 24.4.2003

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.4.1999 “PËR DISPOZITAT
ZBATUESE TË KODIT DOGANOR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të pikës 4 të nenit 199 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin 205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Në shkronjën “a” të pikës 254 të shtohen 2 nënpika, me këtë përmbajtje:

“i) pije alkoolike, verë dhe birrë;

ii) duhan dhe produkte të duhanit.”.

2. Në shkronjën “b”, të pikës 254 shtohen 2 nënpika, me këtë përmbajtje:

“i) pije alkoolike, verë dhe birrë;

ii) duhan dhe produkte të duhanit.”.

3. Në fund të pikës 255 shtohen fjalitë me këtë përmbajtje:

“Pijet alkoolike, vera dhe birra mund t’u shiten vetëm personave mbi 18 vjeç. Cigaret mund t’u shiten vetëm personave mbi 15 vjeç.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.262, datë 24.4.2003

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2003, MIRATUAR PËR KOMISIONIN
QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE PËR HAPJEN E
KUTIVË TË VOTIMIT TË PËRDORUR NË ZGJEDHJET PËR DEPUTET NË KUVENDIN
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË DATËS 24 QERSHOR 2001**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003” dhe nenit 137 pika 2 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2003, t’i shtohet fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh, për financimin e shpenzimeve për hapjen e kutivë të votimit të

përdorura në zgjedhjet për deputet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 24 qershor 2001.

1. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

V E N D I M
Nr.266, datë 24.4.2003

PËR ADMINISTRATAT E ZONAVE TË MBROJTURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit dhe të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe e Kullotave të përcaktojë për parqet kombëtare dhe rezervatet natyrore të menaxhuara (zonat e mbrojtura të kategorive II e IV) administratën e mbrojtjes së tyre, nga stafi i drejtorive të saj në rrethe. Numri i punonjësve të administratës për secilën zonë caktohet në përputhje me statusin, nivelin e saj të mbrojtjes dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit.

2. Administrata e këtyre zonave është në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe e Kullotave dhe trajtimi financiar i punonjësve të saj është i njëjtë me atë të punonjësve të drejtorive të shërbimit pyjor në rreth.

3. Administrata e zonës së mbrojtur përgjigjet edhe për monumentet e natyrës, që ka rrethi, pavarësisht nëse ato ndodhen ose jo në territorin e zonës së mbrojtur.

4. Administrata e zonës së mbrojtur kryen këto detyra dhe shërbime:

a) administron zonat e mbrojtura;

b) ruan zonat e mbrojtura (funksion policie);

c) ndjek zbatimin e planit të menaxhimit të zonës;

ç) ndjek realizimin e programeve vjetore të monitorimit e të biomonitorimit të zonës, në bashkëpunim me institute e katedra të specializuara të ngarkuara me monitorimin dhe publikimin e të dhënave;

d) harton rregulloren për administrimin dhe ruajtjen e zonës dhe rregulloret vendore për peshkimin, për gjuetinë, për mbrojtjen e pyjeve, kullotave, bimëve mjekësore, ku zona ka të tilla;

dh) gjobit në raste kundërvajtjesh dhe vjel gjobat;

e) grumbullon tarifat për përdorimin dhe shfrytëzimin e zonave të mbrojtura;

ë) kontakton përdoruesit e të gjitha llojeve;

f) kontrollon përdoruesit dhe vizitorët;

g) zbaton infrastrukturën e domosdoshme për përdorimin e zonave të mbrojtura;

gj) ndërton skedar rajonal mjedisor, si pjesë e skedarit kombëtar;

h) përdor me frytshmëri fondet për mirëmbajtjen e zonës;

i) publikon çdo vit të dhënat për gjendjen e zonës;

j) dokumenton veprimtaritë, investimet, kërkimet shkencore të kryera në zonë;

k) përgatit dhe publikon çdo fundviti raportin vjetor të gjendjes së zonës dhe e paraqet në Ministrinë e Mjedisit, në DPPK dhe në organet qeverisjes vendore;

l) bashkëpunon me institucione kërkimore shkencore, me OJF-të mjedisore dhe me komunitetin për mbrojtjen e zonës dhe ruajtjen e biodiversitetit të saj;

ll) organizon, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, me institucionet kërkimore-

shkencore, me institucionet arsimore e kulturore, me OJF-të mjedisore, si dhe me komunitetin veprimtari ndërgjegjësuere dhe bën botime të ndryshme, për të bërë të njohura vlerat e zonës;

m) bashkërendon festimin e ditëve dhe ndodhivë mjedisore që lidhen me zonën.

5. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave (DPPK) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.267, datë 24.4.2003

**PËR PROCEDURAT E PROPOZIMIT DHE SHPALLJEN E ZONAVE TË MBROJTURA
DHE BUFERIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 13 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit dhe të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e procedurave për propozimin dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe buferike, si më poshtë vijon:

a) Ministria e Mjedisit përgatit planin e shpalljes së zonave të mbrojtura, ku përcaktohen zonat që synohen të shpallen të tilla, statusi, kufijtë dhe shkalla e mbrojtjes së secilës prej tyre.

b) Plani hartohet në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, me organet e qeverisjes vendore, me institutet kërkimore-shkencore përkatëse dhe me shoqatat mjedisore.

c) Çdo organ e institucion shtetëror, qendror ose vendor, person juridik ose fizik, shoqatë jofitimprurëse ose komunitet, ka të drejtë të paraqesë në Ministrinë e Mjedisit propozime për shpalljen e zonave të mbrojtura, për ndryshimin ose heqjen e statusit të çdo zone të mbrojtur, për zgjerimin ose zvogëlimin e kufijve të zonës dhe për zonimin e brendshëm të tyre.

ç) Për shpalljen e zonave të mbrojtura merret parasysh rrjeti i zonave të mbrojtura, i paraqitur në strategjinë dhe planin e veprimit për biodiversitetin.

d) Në publikimin e planit të zonave të mbrojtura jepet edhe afati njëmuor, brenda të cilit mund të bëhen vërejtje e sugjerime, të cilat paraqiten në Ministrinë e Mjedisit.

dh) Me kalimin e këtij afati dhe, nëse nuk ka pasur vërejtje e kundërshtime, plani quhet i vlefshëm dhe në bazë të tij, Ministria e Mjedisit fillon procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen e projektvendimit për shpalljen e zonave të mbrojtura.

2. Për shpalljen e një zone të mbrojtur përcaktohen, paraprakisht, statusi i saj, kufijtë dhe zonimi i brendshëm, zona buferike rreth saj, administrata e ruajtjes së zonës dhe varësia e saj, mundësitë e përpunimit e të shfrytëzimit të zonës, të ardhurat që mund të krijohen dhe përdorimi i tyre në dobi të zonës, në bazë të studimeve rajonale.

3. Ministria e Mjedisit jep njoftime publike për zonat e mbrojtura, të miratuara, për monumentet natyrore, për drurët e mbrojtur, për llojet e bimëve dhe të kafshëve veçanërisht të mbrojtura, për gjetjet minerare dhe paleontologjike, duke përcaktuar me hollësi kushtet për mbrojtjen e tyre.

4. Për zonat e mbrojtura, të shpallura përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, merr masat për përshtatjen e statusit të tyre, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

5. Ngarkohet Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.268, datë 24.4.2003

**PËR CERTIFIKIMIN E SPECIALISTËVE, PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS
DHE AUDITIMIN MJEDISOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutes dhe të pikës 3 të nenit 31 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave për certifikimin e specialistëve për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor, si më poshtë vijon:

I. Aplikimi për t’u njohur si specialist

Ministri i Mjedisit miraton certifikimin e specialistit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor.

Certifikimi i specialistit përfshin të drejtën për të hartuar raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, angazhimin për të kryer auditimin mjedisor, hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore, thirrjen si ekspert, për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

Të drejtën e aplikimit për t’u certifikuar si specialistë për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor e kanë personat fizikë dhe juridikë, publikë dhe privatë, specialiteti dhe përvoja profesionale e të cilëve lidhet ngushtë me mbrojtjen e mjedisit, si institutet kërkimore-shkencore, laboratorët, katedrat universitare, organizatat jofitimprurëse mjedisore dhe specialistët e fushave të ndryshme.

Punonjësit e administratës publike, funksioni dhe detyra e të cilëve krijojnë konflikt interesash, nuk mund të certifikohen si specialistë, në kuptim të këtij vendimi.

II.Dokumentacioni

Për të kërkuar certifikimin si specialist për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor, aplikanti paraqet në Ministrinë e Mjedisit këto dokumente:

a) kërkesën për t’u certifikuar si specialist;

b) vendimin e gjykatës që e ka regjistruar si person fizik ose juridik; përshkrimin e angazhimeve dhe të rezultateve profesionale e kërkimore-shkencore, në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Shqyrtimi i kërkesës

a) Kërkesa dhe dokumentacioni shqyrtohen nga komisioni i shqyrtimit të kërkesave dhe miratohen nga Ministri i Mjedisit, brenda një muaji nga dita e dorëzimit.

Shqyrtimi i kërkesës mbështetet në kriteret e mëposhtme:

- kërkuuesi duhet të ketë arsimin e lartë dhe të ketë jo më pak se 5 vjet përvojë pune;
- të ketë marrë pjesë në hartimin e një raporti të vlerësimit të ndikimit në mjedis, auditim mjedisor, në një ekspertizë ose vlerësimin e njërit prej tyre;

- të ketë marrë pjesë në projekte ose në studime për mjedisin.

c) Aplikanti pajiset me certifikatë, pas miratimit të kërkesës, ndërsa kur ajo refuzohet, aplikantit i argumentohet me shkrim refuzimi.

ç) Ndaj refuzimit, kërkuuesi mund të ankohet në gjykatë, brenda një muaji nga data e njoftimit.

Regjistri kombëtar i specialistëve

a) Për evidentimin e specialistëve të certifikuar, në Ministrinë e Mjedisit krijohet regjistri kombëtar i specialistëve të certifikuar, sipas rregullave të miratuara nga Ministri i Mjedisit.

b) Regjistri është i disponueshëm për publikun, sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e administrimit.

- c) Çdo fund viti, Ministria e Mjedisit, publikon të dhënat vjetore të regjistrit.
- V. Heqja e certifikatës
- a) Certifikata shpallet e pavlefshme, me urdhër të veçantë të Ministrit të Mjedisit, pas sugjerimit të komisionit të shqyrtimit të kërkesave, kur:
- vërtetohet se specialisti ka mashtruar me të dhënat që ka paraqitur në dokumente;
 - specialisti emërohet në administratën publike me detyrë që mbart konflikt interesash;
 - komisioni vërteton me prova se raportet e vlerësimit të ndikimit në mjedis ose ekspertiza e përgatitur nga specialisti kanë nivel të ulët dhe nuk respektojnë kërkesat ligjore dhe metodike, për hartimin e këtyre dokumenteve.
- b) Urdhri që shpall të pavlefshme certifikatën botohet.
- c) Ndaj urdhrin për shpalljen e pavlefshme të certifikatës, specialisti mund të ankohet në gjykatë brenda një muaji nga shpallja e tij.
- Tarifa
- a) Për shqyrtimin e kërkesës, aplikanti paguan tarifën e shërbimit në shumën 10 000 lekë.
- b) Tarifa paguhet, kur dorëzohet kërkesa për shqyrtim dhe është e pakthyeshme edhe kur kërkesa nuk miratohet.
2. Ngarkohet Ministria e Mjedisit për zbatimin të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.278, datë 8.5.2003

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT KOMBËTAR
TË DIGAVE TË MËDHA (KKDM) DHE TË KËSHILLIT TEKNIK TË PËRHERSHËM TË
DIGAVE (KTPD)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 13 të ligjit nr.8681, datë 2.11.2000, "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave e dambave", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e rregullore së funksionimit të Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM) dhe të Këshillit Teknik të Përhershëm të Digave (KTPD), që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, si dhe të gjitha ministratë e institucionet e tjera qendrore, që merren me studimin, projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe kontrollin e digave e të dambave, të marrin masa për zbatimin e detyrave, që rrjedhin nga kjo rregullore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

RREGULLORE
**PËR FUNKSIONIMIN E KOMITETIT KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA (KKDM) DHE
KËSHILLIT TEKNIK TË PËRHERSHËM TË DIGAVE (KTPD)**

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përcakton mënyrën e funksionimit të Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha dhe të Këshillit të Përhershëm të Digave.

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Neni 2

Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha që më poshtë do të quhet (KKDM), është organ i Këshillit të Ministrave dhe vepron sipas përcaktimit të ligjit nr.8681, datë 2.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 3

KKDM-ja ka për mision:

- a) Organizimin dhe ushtrimin e kontrollit shtetëror mbi sigurinë e digave/dambave, në etapat e studim-projektimit, ndërtimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes.
- b) Përfaqësimin e shtetit shqiptar në Komisionin Ndërkombëtar të Digave të Mëdha (ICOLD) dhe nxitjen e mbështetjen e progresit teknik në fushën e digave/dambave në dobi të zhvillimit ekonomik-shoqëror të vendit.
- c) Plotësimin e të gjitha detyrimeve që vijnë nga anëtarësia e tij në ICOLD, sipas statutit të këtij të fundit (kuotizacionin vjetor dhe pjesëmarrjen në aktivitetet që zhvillon ICOLD-i për digat/dambat) etj.

Neni 4

Misionin e tij KKDM-ja e realizon duke kryer këto detyra:

1. Miraton katalogun e digave/dambave, i cili hartohet nga Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave në bashkëpunim me institucionet ose subjektet që administrojnë diga dhe damba, që do të jenë objekt i punës së tyre.

Si kritere themelore për hartimin e katalogut, janë pasojat ekonomike dhe shkalla e rrezikshmërisë që paraqesin digat/dambat për jetën e njerëzve

2. Organizon dhe drejton punën për hartimin e akteve nënligjore dhe akteve të tjera normative, që rregullojnë veprimtarinë e subjekteve, të cilat merren me projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave/dambave, në bashkëpunim me institucionet studimore dhe organizma të specializuara.

- Këto dokumente përfshijnë edhe rregulloret, udhëzuesit, kushtet dhe normat teknike, qarkoret, kriteret për dhënien e licencave të studimit, projektimit, ndërtimit e kolaudimit të digave/dambave etj.

3. Miraton për çdo digë/dambë:

a) Projektidetë dhe projektzbatimet e digave/dambave të reja, që parashikohen të ndërtohen, si dhe projektet e riparimit ose përmirësimit të digave/dambave, që janë aktualisht në shfrytëzim.

b) Grupin ose specialistin e propozuar nga administratori i digës/dambës për drejtimin e punimeve.

c) Studimin, që duhet të ketë projekti i çdo dige/dambe për valën që krijohet në rast prishjeje të saj, si dhe planin e alarmit, evakuimit dhe ndihmës për popullatën dhe shpëtimin e vlerave materiale, që ndodhen në luginën poshtë digës/dambës.

d) Programin e punës dhe masat preventive të hartuara nga projektuesit, të cilat duhen zbatuar gjatë mbushjes së rezervuarit me ujë për herë të parë.

e) Çdo studim të kryer në një digë/dambë, që lidhet me sigurinë e saj.

f) Kriteret për licencimin e specialistëve për projektimin, ndërtimin, rehabilitimin e kolaudimin e digave/dambave.

4. Organizon dhe ushtron kontrollin fizik dhe dokumentar mbi digat/dambat. Kontrolli ushtrohet në etapat e projektimit, ndërtimit dhe shfrytëzimit të tyre.

a) Kontrollin e projekteve e realizon gjatë shqyrtimit e miratimit të tyre.

b) Kontrollin gjatë punimeve të ndërtimit dhe gjatë shfrytëzimit të digave/dambave, e realizon nëpërmjet Inspektoratit Teknik të Digave (ITD).

5. Ndihmon shfrytëzuesit e digës/dambës, nëpërmjet instituteve dhe byrove të specializuara për përpunimin, interpretimin e të dhënave të aparaturave të dëgjimit të vendosura në trupin e saj. Kontrollon zbatimin e rregullores së digës/dambës.

6. Kërkon nga shfrytëzuesit informacione mbi gjendjen e digave/dambave dhe objekteve anekse të tyre.

7. Pezullon pjesërisht ose plotësisht punimet e ndërtimit dhe kërkon rishikimin e projekteve të zbatimit.

8. Kërkon uljen e nivelit të rezervuarit, sipas rastit deri në boshatisjen e plotë të tij nga uji, në rrethana të caktuara, kur rrezikohet prishja e digës dhe, përveç dëmeve ekonomike, mund të shkaktohen viktima në njerëz.

9. Informon Këshillin e Ministrave jo më pak se një herë në vit për gjendjen dhe sigurinë e digave/dambave, që janë në shfrytëzim duke rekomanduar dhe masat përkatëse që duhen marrë për të garantuar një shfrytëzim normal të tyre.

10. Pagan rregullisht, nëpërmjet Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit kuotizacionin e anëtarësisë në ICOLD.

11. Bashkëpunon me ICOLD-in për kërkesat me karakter informativ për digat/dambat në Shqipëri dhe merr pjesë në aktivitetet ndërkombëtare si kongrese, mbledhje ekzekutive, seminare etj., që organizohen për digat/dambat.

12. Bashkëpunon me komitetet analoge të vendeve të tjera për këmbim përvoja dhe informacioni në fushën e digave/dambave.

13. Administron literaturën teknike, që vjen nga ICOLD-i ose organizata të ndryshme dhe e vë atë në dispozicion të specialistëve që ushtrojnë aktivitet në fushën e digave dhe dambave.

14. Synon kualifikimin e specialistëve, që punojnë në këtë fushë, veçanërisht në shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave/dambave.

15. Sensibilizon opinionin për vlerat e mëdha dhe për pasojat që vijnë nga prishja e një dige duke i ftuar të gjithë të kontribuojnë në ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre.

Neni 5

1. KKDM-ja mbulon problemet që lidhen me funksionimin dhe sigurinë e digës/dambës dhe nënobjekteve të saj. Ai mbulon edhe disa probleme që lindin nga ndikimi i digës në sektorë të tjerë (mjedisi, bujqësia, uji i pijshëm e komunal, hidroenergja, transporti ujor, ekonomia e peshkut jomigrues etj.), si dhe problemet që lindin në brigjet e kupën e rezervuarit të ujit, prandaj anëtarët e tij, krahas drejtimit kryesor të formimit të tyre, duhet të kenë kulturën e nevojshme për të mbuluar edhe problemet e mësipërme. Në ato raste kur problemet janë shumë specifike teknike, kërkohet edhe ndihma e specialistëve të jashtëm.

2. Largimi i një anëtari nga KKDM-ja, bëhet:

- a) me dëshirën e vetë personit;
- b) kur dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- c) kur angazhimi i tij nuk justifikon qenien anëtar i këtij organi.

3. Largimi i një anëtari duhet të shoqërohet me zëvendësimin e tij me një person tjetër duke respektuar rregullat e pikës 4 të këtij neni.

4. Për çdo anëtar të KKDM-së, përzgjedhja duhet të bëhet nga më shumë se një kandidaturë.

Përzgjedhja bëhet nga një komision i caktuar dhe drejtuar nga vetë titullari i ministrisë përkatëse duke shqyrtuar CV-në e secilit.

Në përzgjedhjen e anëtarëve të KKDM-së, krahas cilësive individuale dhe formimit profesional, duhet pasur parasysh edhe mundësia reale e pjesëmarrjes efektive të secilit në veprimtarinë e KKDM-së, me qëllim që të ketë një shpërndarje të pranueshme të ngarkesës tek secili.

5. Të gjithë anëtarët e KKDM-së dhe KTPD-së pajisen me një dokument të lëshuar nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, me të cilin paraqiten pranë subjekteve të projektimit, ndërtimit, shfrytëzimit të digave/dambave dhe institucioneve që kanë në administrim digat/dambat.

6. Të gjitha subjektet e projektimit, ndërtimit, shfrytëzimit të digave/dambave dhe

institucionet që kanë në administrim digat/dambat, plotësojnë në kohë kërkesat që parashtrojnë anëtarët e KKDM-së, KTPD-së.

Neni 6

1. Puna në KKDM-së ndërtohet mbi bazën e një programi të miratuar në fundin e vitit paraardhës. Ajo është e vazhdueshme dhe konkretizohet në analizat e mbledhjeve të KKDM-së. Sipas rastit rezultatet marrin formën e vendimit. Programi i punës, përveç detyrave dhe afateve, duhet të ketë edhe anëtarin ose personin përgjegjës. Ky program shërben si bazë për planet e punës së Sekretariatit Kombëtar të Digave të Mëdha dhe Inspektoratit Teknik të Digave/Dambave.

Neni 7

KKDM-ja zhvillon takime (mbledhje) jo më pak se një herë në muaj. Mbledhjet drejtohen nga kryetari dhe në mungesë të tij nga nënkryetari. Për problemet me karakter teknik, kur miratohen projekte, studime, udhëzues, rregullore teknike etj., pranë KKDM-së si organ këshillimor, funksionon Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD).

Vendimet merren me shumicë votash. Në ato raste kur numri i pjesëmarrësve është çift dhe votat janë të barabarta votat e kryetarit vlerësohen me dy.

Neni 8

1. Kryesia e KKDM-së, në kohën e caktuar, mbasi merr edhe mendimin e të gjithë anëtarëve, miraton shpenzimet për vitin pasardhës dhe i paraqet ato në strukturën përkatëse të Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, për përfshirjen e tyre në buxhetin e vitit pasardhës.

2. Në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë, KKDM-ja pranon donacione të ndryshme, si dhe siguron të ardhura nga shërbimet që ai kryen në favor të një pale tjetër. Këto mjete financiare, si dhe vlera e shpenzimeve e llogaritur sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.444, datë. 5.9.1994 “Për tarifën e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudit të veprave të ndërtimit”, derdhen në llogarinë e Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

Neni 9

1. Arkivi i KKDM-së përbëhet nga tri pjesë:
 - a) Arkivi dokumentar (korrespondenca, vendime, udhëzime, rregullore etj.).
 - b) Arkivi teknik me dokumentacionin përkatës për të gjitha digat/dambat që plotësojnë kriteret e KKDM-së.
 - c) Arkivi i fondit të librave, revistave dhe buletineve tekniko-shkencore.
2. Administrimi i arkivit bëhet nga një specialist brenda Sekretariatit Kombëtar të Digave të Mëdha.

Neni 10

1. KKDM-ja ka vulën përkatëse:
Republika e Shqipërisë Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha Albcold
2. Adresa e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha është:
Republika e Shqipërisë
Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit
Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha
Bulavardi “Dëshmorët e Kombit” Tiranë, Albania
Tel: 00355 4 2570 26, 0035542 570-28
Fax: 00355 42278 79, 003554570-26

KËSHILLI TEKNIK I PËRHERSHËM I DIGAVE

Neni 11

Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave që më poshtë do të quhet (KTPD), është organ këshillimor i Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM), që vepron sipas përcaktimit të ligjit nr.8681, datë 2.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 12

Detyrat kryesore të KTPD-së janë:

1. Harton listën e digave/dambave që do të jetë objekt i veprimtarisë së KKDM-së, në bashkëpunim me institucionet që mbulojnë e administrojnë digën/dambën, të cilën ia paraqet për miratim KKDM-së.

Si kriteret themelore për hartimin e listës do të shërbejnë shkalla e rrezikshmërisë që ato paraqesin për të tretët në rast prishjeje, vlerat ekonomike të tyre.

2. Organizon dhe drejton përgatitjen e dokumentacionit teknik e ligjor që rregullon gjithë procesin e studimit, projektimit, ndërtimit, riparimit, shfrytëzimit e mirëmbajtjes së digave/dambave, në bashkëpunim me institucionet tekniko-shkencore dhe organizata të kualifikuara në fushën e digave /dambave dhe i paraqet për miratim në KKDM.

Këto dokumente përfshijnë vendime të Këshillit të Ministrave, udhëzime të dikastereve, qarkore, kushte dhe norma teknike për projektimin dhe ndërtimin, udhëzues dhe rregullore të ndryshme për shfrytëzimin e mirëmbajtjen.

3. Së bashku me projektin shqyrton dhe miraton:

Grupin ose personin që propozohet nga investitori për drejtimin e punimeve.

b) Studimin mbi karakteristikat e valës që krijohet në rast se prishet diga/damba dhe planin e alarmit të evakuimit dhe mbrojtjes së popullatës dhe vlerave ekonomike, që kërcënohen nga kjo prishje.

c) Programin e punës për mbushjen e rezervuarit me ujë për herë të parë.

d) Aktin e kolaudimit të objektit pas mbarimit të punimeve.

e) Çdo studim që lidhet me sigurinë e digave si p.sh. ndryshimi i klasit të digave/dambave, me ndryshimin e kushteve në zonën ku ndodhet diga/damba.

4. Kërkon informacione nga Inspektorati Teknik i Digave dhe nga dikasteri që mbulon qëllimin e digës/dambës, të cilat i paraqet në KKDM.

5. Ushtron kontroll drejtpërdrejt në digë. Objekt kontrolli janë diga ose damba me nënobjektet e tyre, si dhe dokumentacioni që shoqëron shfrytëzimin e digës, si dhe aparaturat e dëgjimit të vendosura në digë (gjendjen dhe matjet e kryera në to), mbi bazën e programit të miratuar në KKDM.

6. Organizon kontrollin e plotë të digave dhe në rastet kur e sheh të domosdoshme dhe të pashmangshme mund të sugjerojë pranë organeve kompetente uljen e pjesshme ose të plotë të nivelit dhe raportin në KKDM.

7. Ndhmon shfrytëzuesin e objekteve të rëndësishme të përpunojnë matjet e bëra dhe të bëjnë interpretimin e tyre, nëpërmjet institucioneve ose grupeve të specializuara dhe informon KKDM-në.

Pas çdo kontrolli, KTPD-ja lë detyra dhe kërkon plotësimin e tyre në afat, në zbatim të “Rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave”.

Neni 13

1. Anëtarët e KTPD-së përzgjidhen midis specialistëve me përvojë në fushën e studimit, projektimit, ndërtimit dhe shfrytëzimit e mirëmbajtjes së digave dhe dambave, të cilët në punën e tyre janë shquar për arritje të suksesshme dhe miratohen nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.

2. Puna e KTPD-së ka karakter të përhershëm dhe problemet në ndjekje i realizon mbi bazën e programit të punës të miratuar nga KKDM-ja, të cilën edhe e informon rregullisht dhe jo më pak se një herë në muaj.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 17.4.2003
Doli nga shtypi më 18.4.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë

3. KTPD-ja punon sipas një programi vjetor pune, që miratohet nga KKDM-ja në fund të vitit paraardhës.

4. Anëtarët e KTPD-së marrin pjesë në mbledhjet e KKDM-së.

5. Anëtarët e KTPD-së ngarkohen nga KKDM-ja për ndjekjen e problemeve të caktuara duke u konsultuar dhe marrë mendimet e specialistëve të jashtëm.

6. KTPD-ja organizon punën për krijimin e arkivit të dokumenteve të ndryshme, si dhe arkivin me dosjet që përmbajnë dokumentet kryesore për çdo digë pranë sekretarisë së KKDM-së.